


FËMIJËT FLASIN



NË KOSOVË

DEMOKRACIA ËSHTË PAQË

DONAT (12), RIANA (12), JONI (12), NJOMZA (12), BETIM (13), DORUNTINA (12), DIELLZA (12)

Të dashur lexues, përmes artikullit tonë mund ta kuptoni se ç'është demokracia dhe në cilat forma shfaqet ky lloj i qeverisjes

Ne nuk jemi duke jetuar në kohë lufte por jemi duke jetuar në paqe. Pra, paqja është demokraci. Demokracia është vet paqja. Demokracia është mënyrë e qeverisjes së një vendi. Në demokraci të gjithë jemi të barabartë, pa marrë parasysh racën, fenë, kombin apo gjendjen ekonomike. Elementet e demokracisë janë: toleranca, solidariteti, paqja, barazia dhe shprehja e lirë. Populli përmes votës së tij zgjedhë individët e posaçëm për qeverisje. Demokracia lindi për herë të parë në kryeqytetin e Greqisë, pra në Athinën e vitit 507 p.e.s. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ dhe „kratia“ e që në gjuhën shqipe përkthehet në popull dhe në qeverisje. Kjo nënkupton qeverisje e popullit. Mënyra e qeverisjes në demokraci mund të jetë e drejtpërdrejtë nga populli, e që quhet demokraci direkte apo e drejtpërdrejtë. Si dhe përmes përfaqësuesve, e që quhet demokraci përfaqësuese. Toleranca është respekti ndaj të tjerëve. Kurse, solidariteti është ndihma ndaj të tjerëve. Mund ta marim shembull të solidaritetit ndihmën që ua ofrojmë të varfërve në këto ditë të ftohta dimri. Ne si fëmijë kemi të drejta dhe jemi të gjithë të barabartë. Askush nuk ka më shumë të drejta se unë apo ti. Të gjithë jemi të barabartë dhe askush nuk mund të na mohoj të drejtat tona.



Të lumtur që jetojmë në demokraci. Ne jemi shumë të vlefshëm



Të gjithë ne luajmë një rol shumë të rëndësishëm në shtetin tonë



Parimet bazë




Gazetarët e artikullit



Gjatë punës sonë



Ne jemi pjesë e vendimmarrjes lokale



Të gjithë qytetarët kanë të drejtën e votës



Fëmijët duke vizatuar kutinë e votimit




Kuvendi, institucion legjislativ



Shtëpia jonë




Gazetarët e demokracisë duke shkruar artikullin



Elementet karakteristike të një deputeti


ZËRI I POPULLIT NË KUVEND

LUM (12), JETA (12), ALBI (12), RINA (12), VALZA (13), DRION (13), DIESA (12), BLENDI (12)



Si shumë shtete të tjera demokratike në botë edhe Kosova e ka një Kuvend. Ne mendojmë se Kuvendi i Republikës sonë, e bën shtetin tonë një vend më të mirë dhe më demokratik

Kuvendi i Kosovës është vendi ku mbledhën deputetët. Kuvendi i Kosovës mund të quhet ndryshe shtëpia e popullit. Deputetët e Kosovës e kanë të drejtën e votës. Ata votojnë për të zgjedhur kryetarin e shtetit, për të zgjedhur Kryetarin e Kuvendit dhe për të zgjedhur Qeverinë.



Përveç këtyre detyrave, ata kanë për detyrë edhe të bëjnë ligje të reja. Po ashtu edhe të kontrollojnë Qeverinë të cilën vet e kanë zgjedhur.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka tri funksione: përfaqësues, legjislativ dhe kontrollues. Funksioni përfaqësues është se përfaqësojnë popullin, funksioni legjislativ është se bëjnë ligje, ndërsa funksioni kontrollues është se kontrollojnë Qeverinë.

Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë.

100 prej tyre janë qytetarë shumicë ndërsa njëzet iu përkasin komuniteteve jo shumicë. Në komunitetet jo shumicë bëjnë pjesë: serbët, ashkalinjtë, turqit, romët etj.

Në Kuvend sipas ligjit, 30 % e ulëseve janë të garantuara për gratë. Kurse, momentalisht në Kuvend janë 32.5 % gra, ose thënë ndryshe 39 deputete gra dhe 67.5 % burra ose 81 deputetë.

Format e votimit janë: me dorë, me shkrim (me letër) dhe në mënyrë elektronike. Zakonisht deputetët votojnë në mënyrë elektronike ose me dorë për ligjet e reja, kurse votojnë me shkrim kur kanë për të zgjedhur Presidentin e shtetit. Por, deputetët nuk mund të votojnë pa pasur kuorum, e kuorumi është kur në sallën seancës plenare janë të pranishëm më shumë se 50 % apo 60+1 e deputetëve.

E ardhmja e shtetit varet nga ne. Secili prej neve, me profesionet që kemi zgjedhur për të ardhmen, do të kontribuojmë që Kosova të jetë shtet sa më i zhvilluar dhe në këtë mënyrë ta forcojmë demokracinë tonë.




Autorët e këtij artikulli

NDRYSHIMI FILLON NGA TI

PLARENTA (12), DIELLZA (12), MEGZONI (12), DIONI (12), ELSA (12), ERJANA (11), MUHAMETI (12)

Gjykata Supreme



Jemi ne ata që i zgjedhim përfaqësuesit tanë. Jemi ne që vendosim se kush do të qeverisë me vendin dhe jemi ne ata që e japim fjalën e fundit

Kosova është një shtet demokratik në zhvillim e sipër. Prandaj, pushteti në vendin tonë ndahet për disa arsye të cilat janë: një institucion nuk mund t'i përfundojë vetëm të gjitha punët sepse do të ishte ngarkesë e madhe, e gjithashtu edhe puna nuk do të ishte e cilësishë së lartë. Për këto arsye të cilat janë mjaft logjike, pushteti në demokraci ndahet në pushtetin legjislativ, pushtetin ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor. Udhëheqja edhe pse ndahet, nuk do të thotë se nuk ka bashkëpunim në mes të këtyre pushteteve.

Pushtetin legjislativ e ka Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kuvendi është institucioni më i lartë shtetëror. Kuvendi i Kosovës përfaqëson shtetin dhe popullin, miraton, shfuqizon dhe propozon ligje, mbikëqyr punën e Qeverisë, dhe zgjedhë Qeverinë dhe Presidentin e shtetit.



Gazetarët e nderit

Funksionet e Kuvendit të Kosovës janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni kontrollues. Funksioni përfaqësues quhet ashtu sepse janë deputetët ata të cilët na përfaqësojnë neve. Deputetët zgjedhen nga vet ne. Ne jemi ata të cilët e bëjmë ndryshimin. Funksioni legjislativ e ka kuptimin e nxjerrjes apo miratimit të ligjeve. Kuvendi ka të drejtë të propozojë ligje, t'i miratojë ose mos t'i miratojë ligjet të cilat i propozojnë deputetët apo Qeveria. Funksioni i kontrollues, është kontrolli i punës së Qeverisë.

Pushtetin Ekzekutiv e ka Qeveria e Kosovës. Punët në Qeveri i kryejnë kryeministri dhe ministrat e ndryshëm të cilët udhëheqin ministrinë përkatëse të Kosovës. Qeveria i jep llogari Kuvendit, sepse Qeveria zgjedhet nga vet Kuvendi. Pushteti i tretë është pushteti Gjyqësor, mirëpo nuk do të thotë se është më pak i rëndësishëm.

Gjykatat ndahen në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme.

Në gjykatë punët i kryejnë gjykatësat, prokurorët dhe avokatët e ndryshëm etj. Gjykatat merret me persona, për të cilët dyshohet se kanë kryer vepra në kundërshtim me ligjin. Gjykata Themelore gjendet në çdo komunë, ndërsa Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme ndodhet vetëm në kryeqytet. Ne duhet ta dimë se këtë pushtet e kemi zgjedhur ne vet, andaj jemi të barabartë me pushtetin dhe zëri ynë ka vlerë.



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë